



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:042230

Datë: 24.06.2020

Numri i dokumentit: 00995738

**P. nr.1012/2018**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtari individual Adem Shabani, zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.A, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Shtime, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1284-3/2018, të dt. 27.07.2018, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurores së shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarit A.A, me datën 24.06.2010 , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari A.A, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Shtime, i lindur me dt...., nga i ati R... dhe e ëma H... e gjinisë A..., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, gjendjes së mesme, prindër i një fëmije me numër personal ..., mbrohet në liri.

### **ËSHTË FAJTORË**

Sepse:

Me datë 08 Qershor 2018, rreth orës 24:00, në shtëpinë e tyre të përbashkët në fshatin ..., pas një fjalosje, i mll皇甫ur për shkak se e dëmtuara-bashkëshortja G.A, vonohet pasi që kishte qenë në iftar te halla e saj, i pandehuri me dashje që ti shkakton lëndime trupore fillimit e ka goditur me flakaresh në fytyrë e pastaj edhe e ka kapur për fyti dhe duar, për pasojë e njëjta pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

***-me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.***

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 49, 50, 51, 52 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe neneve 361, 365 dhe 450 të KPPRK-së :

## G J Y K O N

Të akuzuarit A.A, i shqipton denim me kusht prej katër (4) muaj burgim, i cili denim pra nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepë rtjetër penale.

Të dëmtuaren G.A, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor në shumën prej 40 €, dhe taksën në shumën prej 30 €, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1284-3/2018, të dt. 27.07.2018, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin A.A, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Shtime, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.24.06.2020, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Ajtene Zoni akuzuarit A.A, ku me ftesë të rregullt është ftuar edhe e dëmtuara G.A, por nga fletë kthesa për dorëzim persona është cekur se nuk banon në adresën e kërkuar.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurorja e shtetit Ajtene Zoni ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, dhe konsultimit me avokatin e tij të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohe mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari A.A, ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim ka deklaruar se të dëmtuarën G... e ka pasur bashkëshorte por tani me te nuk jeton dhe është kthyer tek prindit e saj në Republikën e Maqedonisë, atë natë ka qenë i mllëfosur për shkak se bashkëshortja G... ka qenë në iftar te halla e tij dhe është vonuar dhe ka ardhur deri tek konflikti me te në ato momente nuk ka mundur që të përmbahet dhe e ka goditur me flakësh në fryrës dhe me te pas këtij rasti ka ndërpre çdo lidhe dhe se nuk ka patër më të keqe me te, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqyrtimit të dënimit si rrethana lehtësuese të merr për bazë theksimet e cekura më parë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë. dëmtuarit.

Prokurorja e shtetit Ajtene Zoni ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata të merr për bazë gjendjen jo të mirë të tij shëndetësore.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në Raportin mjekësor i lëshuar nga QKMF, në Shtime, me numër të protokollit 798 dt.08.06.2018, akt ekspertimi mjeko ligjor mby natyrën e lëndimeve të dëmtuarës G.A, si dhe në shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës penale.

*Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të neneve 73 dhe 74 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për veprën e kryer penale, kërkim falje të dëmtuarës ku ka qenë bashkëshortja e tij, për shkak të gjendjes që ishte i shqetësuar nga veprimet e të dëmtuarës në ato momente nuk ka mundur që ta kontrollon veten, është ndarë nga e dëmtuar dhe nga rasti për të cilin akuzohet më me te nuk ka pas diçka të keqe, ka premtuar se më nuk do të përsëris vepra të tilla, është i gjendjes jo të mirë ekonomike dhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 par.1 lidhur me par.3 të KPPK-së të dëmtuarën G.A, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Bazuar në nenet 450 dhe 451 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të paguaj paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor në shumën prej 40 €, dhe taksën në shumën prej 30 €, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditëve

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.1012/2018 me dt.24.06.2020**

**Zyrtare Ligjore**  
Kadishe Shabani

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.